

Vendim nr. 265 datë 11.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marsida Xhaferllari, Anëtare
Marjana Semini, Anëtare

në datën 11.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 28 (Sh) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: SHOQËRIA “EUROFISH” SH.P.K., përfaqësuar nga administrator Drini Shkreli.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit të datës 20.02.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit “Për kthimin e rekursit”; vendimit nr. 00-2023-2775, datë 03.07.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika 1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut” (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shoqëria “EUROFISH” sh.p.k. (*kërkuesja*) ushtron aktivitetin tregtar të prodhimit, shitjes, blerjes, importit dhe eksportit të produkteve të peshkut, lëndëve të para etj. Gjatë ushtrimit të aktivitetit ka qenë subjekt kontrolli nga Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj (*DRTTM*) për periudhën 2011- 2012, për të cilin ky institucion ka nxjerrë njoftimvlerësimin nr. 14233/13, datë 30.08.2012 për detyrimin tatimor të kërkueses në vlerën 6. 607.319 lekë. Ky detyrim përfshin tatimin mbi fitimin për vitin 2011, TVSH-në për vitet 2011-2012 dhe gjobat respektive.

2. Kërkuesja, pas ankimit administrativ pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor dhe lënies në fuqi nga ky institucion të vendimit të DRTTM-së, në datën 01.02.2013 ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt shfuqizimin e njoftimvlerësimit nr. 14233/13, datë 30.08.2012 të DRTTM-së.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 7074, datë 24.06.2013, ka vendosur rrëzimin e padisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur apel kërkuesja.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2127, datë 14.05.2014, ka shpallur moskompetencën për shqyrtimin e çështjes, duke e dërguar për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit.

5. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 3297, datë 21.07.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesja.

6. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2016-2400(341), datë 08.06.2019, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë.

7. Pas rishqyrtimit, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 316, datë 29.09.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit. Kundër këtij vendimi në datën 27.01.2023 ka paraqitur rekurs kërkuesja. Gjykata e apelit, pasi ka verifikuar kushtet formale të rekursit, ka vlerësuar se ai ishte me të meta, për shkak se nuk ishte nënshkruar nga një avokat i autorizuar me tagrat e nënshkrimit të rekursit dhe me vendimin e datës 03.02.2023 ajo gjykatë ka urdhëruar plotësimin e të metave brenda 5 ditëve. Kërkuesja, pasi ka plotësuar të metat, ka paraqitur rekursin në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 08.02.2023.

8. Në vijim, në datën 20.02.2023 Gjykata Administrative e Apelit ka disponuar me vendim për kthimin e rekursit, duke arsyetuar se rekursit nuk i janë bashkëngjitur aktet për

plotësimin dhe ndreqjen e të metave në lidhje me nënshkrimin e tij nga avokati i autorizuar me këto tagra, si dhe formati i rekursit të njoftuar me vendimin e ndërmjetëm të datës 03.02.2023.

9. Pasi është njohur me këtë vendim të gjykatës së apelit, kërkuësja në datën 07.03.2023 ka paraqitur rekurs të veçantë kundër vendimit për kthimin e rekursit.

10. Në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-2775, datë 03.07.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të veçantë, me arsyetimin se rekursi nuk ngre shkaqe nga ato të parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të nenit 58 të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, (ligji nr. 49/2012), i cili bën të mundur shqyrtimin në themel të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Po kështu, ajo gjykatë ka theksuar se është detyrë e palës rekursuese të parashtojë qartësisht dhe në mënyrë të plotë në rekurs shkaqet ligjore, duke argumentuar se përse është zbatuar në mënyrë të gabuar ligji material apo procedural dhe cilat janë ato shkelje të rënda procedurale që ndikojnë në dhënien e vendimit, gjë të cilën kërkuësja nuk ka arritur të parashtojë sipas kërkesave të nenit 58 të ligjit nr. 49/2012.

11. Në datën 04.09.2024 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit i cili pasi është plotësuar sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/200, është regjistruar në datën 19.09.2024.

II

Pretendimet e kërkueses

12. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

12.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:

12.1.1. *Së drejtës së ankimit*, parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës, për shkak të vendimmarrjes së Gjykatës Administrative të Apelit dhe vendimit të Kolegjit Administrativ. Në këtë mënyrë kërkuësi është ndaluar për të ushtruar të drejtën e rekursit. Rekursi është plotësuar brenda 5 ditëve, por pavarësisht kësaj gjykata e apelit ka vendosur kthimin e tij, duke iu cenuar në thelb kërkueses liria dhe e drejta e ankimit. Kërkueses i është njoftuar vetëm vendimi dhe dëftesa e komunikimit, por nuk i është kthyer fizikisht rekursi.

12.1.2. *Gjykatës së paanshme*, pasi i njëjti gjyqtar që ka shqyrtuar çështjen në Gjykatën Administrative të Apelit, dhe ka dhënë vendimin jo në favor të kërkueses, ka kryer edhe verifikimin e anës formale të rekursit, me pasojë kthimin e tij.

12.1.3. *Standardit të arsytimit të vendimeve gjyqësore*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 00-2023-2775, datë 03.07.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit pa dhënë përgjigje për asnjë nga shkaqet e rekursit. Ai është thjesht një vendim mospranimi rutinë *copy paste*.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, pra mjafton mosplotësimi i njërit prej këtyre kriterëve që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.

14. Kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor për të cilin ka ngritur pretendimet në Gjykatë, për rrjedhojë provon interesin e drejtpërdrejtë në këtë çështje.

15. Lidhur me kriterin e *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, që pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: i) kur kërkuesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive përpara se t'i drejtohet gjykatës; ii) ose kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete efektive në dispozicion.

16. Bazuar në aktet bashkëlidhur kërkesës, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje në bazë të rekursit të paraqitur nga kërkuësja, për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës

Administrative të Apelit të datës 20.02.2023, me të cilin ajo gjykatë ka vendosur kthimin e rekursit, me arsyetimin se nuk ishin plotësuar të metat sipas përcaktimeve ligjore. Pasi është njohur me këtë vendim, kërkuesja ka paraqitur rekurs të veçantë kundër vendimit për kthimin e rekursit, për të cilin Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi e ka shqyrtuar, me vendimin nr. 00-2023-2775, datë 03.07.2023, ka vendosur mospranimin e tij, duke vlerësuar se rekursi nuk plotëson kriteret e nenit 58 të ligjit nr. 49/2012. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesja i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion dhe nuk ka mjete të tjera juridike për pretendimet ndaj vendimit të Gjykatës së Lartë.

17. Për legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Për sa i përket përmbushjes së këtij kriteri, Kolegji konstaton se vendimi i kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 03.07.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 04.09.2024, pra dukshëm jashtë afatit ligjor 4-mujor nga data e marrjes dijeni për vendimin e kundërshtuar.

18. Nga informacioni zyrtar i marrë nga Gjykata e Lartë, për shkak të shqyrtimit paraprak, rezulton se vendimi i Kolegjit Administrativ është bërë i disponueshëm për palët në faqen zyrtare të kësaj gjykate në datën 14.09.2023. Në ankimin kushtetues individual kërkuesja nuk paraqet asnjë argument për arsyet e paraqitjes së kërkesës jashtë afatit ligjor dhe as për vënien në dijeni në lidhje me këtë vendim.

19. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

20. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk përmbush kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.